



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 11/2021 regjistër (JD)
Datë 02.11.2021

Nr. 4 vendimi
Datë 27.01.2022

VENDIM

**PËR MOSKALIMIN E ÇËSHTJES
PËR SHQYRTIM NË SEANCË PLENARE**

Kolegji për Shqyrtimin Paraprak, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Anëtare
Ardian Hajdari	Anëtar
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 27.01.2022, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 11, datë 02.11.2021, që i përket:

KËRKUES: Edmond Kasmi.

SUBJEKT I

INTERESUAR: Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

OBJEKTI:

Shfuqizimi i vendimit nr. 201/4 prot., datë 26.05.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; detyrimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të fillojë hetimin për magjistratin I. T., anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Tiranë; Pezullimi i magjistratit I. T., anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas parashikimeve të Kushtetutës.

BAZA LIGJORE: Neni 131, shkronja “f”, neni 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, neni 179, pika 7, dhe neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar; ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën

e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Kolegji për Shqyrtimin Paraprak të kërkesës, pasi dëgjoi gjyqtaren relatores Natasha Mulaj, shqyrtoi në dhomë këshillimi kërkesën e kërkuarit dhe aktet bashkëlidhur, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Kërkuarisi Edmond Kasmi ka kandiduar dhe është pranuar në formimin fillestar për magistrat, në profilin gjyqtar, në Shkollën e Magistraturës.
2. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), me vendimin nr. {***}, datë 20.07.2020, ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë të kandidimit për formimin fillestar në Shkollën e Magistraturës për kandidatët për magistratë, profili gjyqtarë, duke caktuar relator anëtarin e KLGj-së, z. I. T.
3. Kërkuarisi u është drejtuar me letër të hapur anëtarëve të KLGj-së, duke pretenduar se në procedurën e ndjekur ndaj tij, relatori I. T. kishte kryer shkelje penale dhe disiplinore, duke sjellë mangësi në procesin e verifikimit të kandidaturës së kërkuarit për kriterin e pasurisë.
4. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, pas përcjelljes për verifikim, nga kryetarja e KLGj-së, të letrës së kërkuarit dhe pas kryerjes së hetimeve, në datën 18.02.2021, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.
5. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. {***}, datë 11.02.2021, ka vendosur: *Skualifikimin e kandidatit, z. Edmond Kasmi, për në formimin fillestar në Shkollën e Magistraturës, për magistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2020-2021.*
6. Kërkuarisi ka kundërshtuar vendimin nr. {***}, datë 11.02.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila, me vendimin nr. {***}, datë 17.03.2021, ka vendosur rrezimin e padisë.
7. Kërkuarisi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, regjistruar në datën 04.06.2021, duke kërkuar: *Shfuqizimin e vendimit nr. {***}, datë 11.02.2021, “Për skualifikimin e kandidatit, z. Edmond Kasmi, për në formimin fillestar në Shkollën e Magistraturës, për magistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2020-2021”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kualifikimin për në formimin fillestar në Shkollën e Magistraturës për magistrat, profili gjyqtar, të kandidatit Edmond Kasmi në vitin akademik 2020 -2021.* Sipas të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, rezulton se Kolegji Administrativ i Gjykatës së

Lartë, me vendimin nr. {***}, datë 23.09.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit të palës paditëse Edmond Kasmi kundër vendimit nr. {***}, datë 17.03.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit.

8. Kërkuesi i është drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në datat 25.01.2021 dhe 12.04.2021, duke paraqitur dy ankesa për shkelje disiplinore ndaj anëtarit të KLGj-së, z. I. T., në cilësinë e relatorit të çështjes në procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës pranë KLGj-së, të kandidaturës së tij.
9. Me vendimin nr. {***} prot., datë 26.05.2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur: "*1. Arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të ankuesit, z. Edmond Kasmi, me nr. {***} prot., datë 25.01.2021 dhe nr. {***} prot., datë 12.04.2021 ndaj veprimtarisë së anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. 2. Të njoftohet ankuesi, z. Edmond K., dhe anëtari i KLGj-së me rezultatet e mësipërme. 3. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Gjykatën Kushtetuese, sipas nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.*
10. Kërkuesi është njoftuar për vendimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesave të tij, me shkresën nr. {***} prot., datë 26.05.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
11. Kërkuesi Edmond Kasmi, në datën 01.06.2021, ka paraqitur ankim në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. {***} prot., datë 26.05.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. {***}, datë 16.09.2021, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare dhe dërgimin e akteve të çështjes Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
12. Kërkesa e kërkuesit Edmond Kasmi është regjistruar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, në regjistrin e çështjeve të Juridiksionit Disiplinor, me (JD) nr. 11/2021, datë 2.11.2021.

II. PRETENDIMET E KËRKUESIT

13. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese [Kolegjit të Posaçëm të Apelit], duke kërkuar:
 - *Shfuqizimin e vendimit nr. {***} prot., datë 26.05.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*
 - *Detyrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të fillojë hetimin për magjistratin I. T., anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
 - *Pezullimin e magjistratit I. T., anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas parashikimeve të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.*

Më konkretisht, ai ka parashtruar se:

14. Magjistrati I. T., anëtar i KLGj-së, në cilësinë e relatorit, gjatë procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, në gjetjet lidhur me kriterin e pasurisë, si dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, në vendimin nr. {***}, datë 11.02.2021, nuk kanë vlerësuar faktet, por i kanë injoruar ato me vetëdije

të plotë, pa marrë në konsideratë rezultatet e verifikimit të kryer nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, të vitit 2017, në kohën kur kërkuesi ka kandiduar dhe është kualifikuar për pozicionin “Komisioner Publik” për organet e rivlerësimit, duke vepruar në kundërshtim me ligjin dhe Kushtetutën. Megjithëse proceset e verifikimit janë bërë nga të njëjtat institucione, rezultatet e verifikimit si kandidat në vitin 2017, kanë qenë ndryshe nga rezultatet e vitit 2020, pra, sipas kërkuesit, i njëjti person është vlerësuar në mënyra të ndryshme. Këshilli i Lartë Gjyqësor, procesin e verifikimit të zhvilluar në vitin 2017, e ka konsideruar formal, kurse procesin e zhvilluar në vitin 2020, e ka vlerësuar substancial. Vendimi i KLGj-së, sipas tij, është haptazi i paligjshëm në raport me parimin e proporcionalitetit dhe sigurisë juridike.

15. Procesi i verifikimit në Këshillin e Lartë Gjyqësor, informacioni që i është kërkuar nga relatori dhe pyetjet që i janë drejtuar kanë qenë me tendencë konfunduese dhe sugjestionuese, dhe të papranueshme për një proces objektiv.
16. Gjatë kohës që kryhej procedura e verifikimit në Këshillin e Lartë Gjyqësor, ka pasur ndërhyrje të papërshtatshme për korrupsion nga persona të tretë, për të cilat kërkuesi ka vënë në dijeni me letër të hapur gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, letër e cila i është përcjellë për verifikim Strukturës së Posaçme Antikorrupsion.
17. Vendimi nr. {***}, datë 26.05.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas kërkuesit, bie ndesh me nenin 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka hetuar nëse ushtrimi i funksioneve nga magjistrati është bërë në mënyrë të pavarur, të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjykime. Po kështu, sipas kërkuesit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka hetuar në drejtim të parashikimeve të nenit 101 të ligjit nr. 96/2021, i cili përcakton shkeljet disiplinore, çështjet e veprimtarisë së magjistratit dhe pakujdesinë në ushtrimin e detyrës, si dhe nuk ka marrë parasysh parashikimet e nenit 102, pika 2 e këtij ligji, për shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit.

III. VLERËSIMI I KOLEGJIT PËR SHQYRTIMIN PARAPRAK

A. Juridiksioni për shqyrtimin e çështjes

18. Juridiksioni dhe kompetenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në kuadër të Juridiksionit Disiplinor, është trajtuar në vendimin nr. 2/2018 (JD), sipas të cilit:
 - 3.1.1. *Juridiksioni Disiplinor i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, është një juridiksion kushtetues, i cili do të shoqërojë veprimtarinë e kësaj trupe përgjatë gjithë mandatit të saj 9- (nëntë) vjeçar, sipas parashikimeve të nenit 179, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas së cilës: “Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar, gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i*

Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë [...]”.

Sipas asaj që parashikon neni 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji i Posaçëm i Apelit do të mbështetë veprimtarinë e tij gjatë ushtrimit të Juridiksionit Disiplinor në:

a) Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;

b) ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar;

c) legjislacionin që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

19. Legjislacioni në fuqi që rregullon çështjet disiplinore të magistratëve dhe të anëtarëve të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, përfshin ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
20. Sipas parashikimeve të neneve 6 dhe 104 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Gjykata Kushtetuese shqyrton ankimet kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose mbylljen e hetimit ndaj anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
21. Bazuar në nenin 6 të ligjit 115/2016, i lidhur me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, që parashikon se gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare, Gjykata Kushtetuese do të funksionojë me dy kolegje, Kolegji për Shqyrtimin Paraprak vëren se shqyrtimi i ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose mbylljen e hetimit ndaj anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, bëhet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, si pjesë e juridiksionit disiplinor të tij.

B. Vlerësimi i pretendimeve të kërkuarit

22. Kërkuari Edmond Kasmi i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit, duke kërkuar:
 - *Shfuqizimin e vendimit nr. {***} prot., datë 26.05.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;*
 - *Detyrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të fillojë hetimin për magistratin I. T., anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Tiranë;*
 - *Pezullimin e magistratit I. T., anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas parashikimeve të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.*
23. Kolegji për Shqyrtimin Paraprak ka konstatuar se në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. {***}, datë 13.12.2021, të KLGj-së, është deklaruar mbarimi i mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. I. T. Ky vendim ka hyrë në fuqi menjëherë, dhe z. I. T. nuk e ushtron më funksionin e tij si anëtar i KLGj-së, prej datës 13.12.2021.

Për sa më sipër, Kolegji për Shqyrtimin Paraprak çmon se gjatë shqyrtimit të kërkesës duhet të marrë në konsideratë këtë rrethanë të re, të konstatuar pas regjistrimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

24. Kërkuesi i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit me kërkesën për shfuqizimin e vendimit nr. {***} prot., datë 26.05.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në këtë vendim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur: *1. Arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të ankuesit, z. Edmond Kasmi, me nr. {***} prot., datë 25.01.2021 dhe nr. {***} prot., datë 12.04.2021 ndaj veprimtarisë së anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. I. T.*

Në përmbajtje të arsyetimit dhe të vendimmarrjes së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është shqyrtimi dhe vlerësimi i ankimit të kërkuesit ndaj veprimtarisë së z. I. T., si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kolegji për Shqyrtimin Paraprak vlerëson se, pas përfundimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. I. T., vendimi nr. {***} prot., datë 26.05.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është një akt administrativ individual që i ka pushuar efektet juridike.

Legjislacioni në fuqi (*ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*) nuk parashikon shtrirjen e përgjegjësisë disiplinore të një ish-anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të mandatit të tij. Në mungesë të një parashikimi ligjor, çdo ankim ndaj veprimtarisë së ish-anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga organet e parashikuara në kuadër të juridiksionit disiplinor.

Për sa më sipër, në kushtet kur vendimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i ka pushuar efektet e tij, kërkesa e kërkuesit Edmond Kasmi për shfuqizimin e tij ka mbetur pa objekt, dhe nuk mund të shqyrtohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit.

25. Kërkuesi, në kërkesën drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ka kërkuar edhe: *Detyrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të fillojë hetimin për magjistratin I. T., anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

Sipas legjislacionit në fuqi, asnjë subjekt nuk mund t’i drejtohet drejtpërdrejt Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për të kërkuar detyrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të fillojë një hetim disiplinor. Sipas parashikimeve të neneve 6 dhe 104 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit shqyrtohen vetëm ankimet ndaj akteve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për arkivimin ose mbylljen e hetimit ndaj një anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Vetëm në rast shfuqizimi të vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të vendosë detyrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të filluar një procedurë hetimi.

Në kushtet kur vendimi nr. {***} prot., datë 26.05.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk mund të shqyrtohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, për arsyet e parashtruara më sipër, edhe kërkesa e kërkuarit për detyrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të filluar hetimin ndaj ish-anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor I. T., nuk mund të shqyrtohet në Kolegj.

26. Gjithashtu, referuar sa më sipër, Kolegji për Shqyrtimin Paraprak çmon se nuk qëndron dhe nuk mund të shqyrtohet as kërkesa për pezullimin e magjistratit I. T., si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi ky magjistrat aktualisht nuk e ushtron më funksionin e anëtarit të këtij këshilli.
27. Bazuar në sa më sipër, Kolegji për Shqyrtimin Paraprak çmon se kërkesa nuk është më në kompetencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe nuk mund të shqyrtohet në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji për Shqyrtimin Paraprak, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronja “a” e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Tiranë, më 27.01.2022.

ANËTAR

Ardian Hajdari

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha Mulaj

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol Çomo

nënshkrimi